

LESSON OF ALBANIAN LANGUAGE, COMPETENCES AND LEVEL OF LEARNING BY SCHOOL CURRICULUM

Ismet OSMANI

University „Ss. Cyril and Methodius“ Skopje“, Faculty of Philology „Blaze Koneski“,
Albanian Language and Literature
ismet_osmani@yahoo.com

UDC 811.18:37.091.214

Conference paper

Abstract

Teaching native language at school is important for development and progress of students at school and it is indispensable foundation for intellectual, social and emotional development. It is closely related to the various cognitive abilities and related to the basic tools for appropriation of the most varied fields of knowledge.

During the study of Albanian language, primary and secondary school students meet with multiple language concepts. Curriculum programs of Albanian language help students from the beginning of education to the end of secondary education to learn many language concepts and rules of every level of language taught in school.

Keywords: *Albanian language, curriculum, language concepts, language rules.*

Përmbledhje

Mësimi i gjuhës amtare në shkollë është çelësi kryesor i zhvillimit dhe përparimit të nxënësve në shkollë dhe bazë e domosdoshme në zhvillimin intelektual, shoqëror dhe emocional. Ajo është e lidhur ngushtë me aftësitë e ndryshme njohëse dhe mjetet themelore të përvetësimit të fushave më të larmishme të dijes.

Gjatë mësimit të gjuhës shqipe nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme takohen me koncepte të shumta gjuhësore. Programet e kurrikulës së gjuhës shqipe ndihmojnë nxënësit që nga fillimi i arsimit e deri në përfundimin e shkollimit të mesëm të mësojnë shumë koncepte dhe rregulla gjuhësore të çdo niveli të gjuhës që mësohen në shkollë.

Fjalët kyçe: *Gjuhë shqipe, kurrikulë, koncepte gjuhësore, rregulla gjuhësore.*

Hyrje

Gjuha është një ndër veçoritë themelore të një kombi në jetën dhe zhvillimin e tij. Mësimi i gjuhës amtare është çelësi kryesor i zhvillimit dhe përparimit të nxënësve në shkollë dhe bazë e domosdoshme në zhvillimin intelektual, shoqëror dhe emocional. Ajo është e lidhur ngushtë me aftësitë e ndryshme njohëse dhe mjetet fundamentale të përvetësimit të fushave më të larmishme të dijes. Gjatë mësimit të gjuhës shqipe nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme takohen me koncepte të shumta gjuhësore.

Plan-programet e gjuhës shqipe ndihmojnë nxënësit që nga shkolla fillore e deri në përfundimin e shkollimit të mesëm të mësojnë shumë terme dhe rregulla gjuhësore të çdo niveli të gjuhës që mësohet në shkollë. Hartuesit e kurrikulave duhet t'i kenë parasysh dy elemente të rëndësishme: mësimdhënien dhe procesin mësimor, sepse mësimdhënia dallon nga procesi mësimor dhe përkufizohet si një sistem personaliteti i mësuesit në klasë. Mësuesi, duhet t'ia lehtësojë nxënësit përvetësimin e njohurive në klasë, duke krijuar raporte bashkëveprimi në realizimin e detyrave të parapara.

Objektivat e kurrikulës bëhen më funksionale në procesin e mësimit vetëm duke krijuar një raport të angazhimit të mësuesit dhe nxënësit në procesin edukativo-arsimor. Hartuesit e kurrikulave nga lënda e gjuhës shqipe, në mënyrë strukturale kanë ndjekur, por edhe sot ndjekin ndarjen tradicionale në të gjitha nivelet, duke i ndarë në zëra njësitë mësimore nga gjuha, si p.sh. nga fusha e fonologjisë, fonetikës, leksikologjisë, morfologjisë dhe sintaksës. Në bazë të përfaqësimit të njohurive gjuhësore, përkatësisht gramatikës së gjuhës amtare në plan-programet e gjuhës, dukej qartë se gramatikës i kushtohet një rol dytësor.

Njësitë mësimore nga gramatika e gjuhës shqipe dhe drejtshkrimi janë të pakta dhe nuk ju krijojnë hapësirë të mjaftueshme nxënësve që në mënyrë të denjë të përvetësojnë njohuri mbi drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin. Plan-programet e deritanishme në mënyrë implicite vënë në dukje se njohuritë gramatikore janë të nevojshme për të fituar përvojën gjuhësore në fusha të ndryshme.

Prandaj, është e nevojshme që plan-programet e gjuhës amtare, por edhe të të gjitha fushave të tjera hartohen sipas një paradigme të re për nevojat e të tashmes dhe të ardhmen. Duhet të hartohen në përputhshmëri me vizionin arsimor që ka për bazë zhvillimin e vendit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Qasja futuriste ndaj programeve të gjuhës duhet t'u përgjigjet nevojave të nxënësve jo vetëm si punonjës të ardhshëm, por edhe si personalitet.

Mbi plan-programet e gjuhës shqipe

Mësimi i gjuhës amtare në të kaluarën zhvillohej në bazë të teksteve të gramatikës dhe të këndimit. Kështu, në vitet '20 të shekullit të kaluar mësimi i gjuhës fillon të zhvillohet me plan-program, në të cilët vihej në spikamë dashuria ndaj gjuhës amtare, si dhe puna me nxënës për të folur e shkruar drejt në gjuhën shqipe. Në të gjitha shkollat shqipe brenda dhe jashtë shtetit amë, ju rekomandohej mësuesve të gjuhës që t'ua mësojnë drejt gjuhën amtare dhe t'ju sigurojë atyre shijen për gjuhën dhe ndjenjat më të bukura.¹Në këtë mënyrë, vazhdimisht nxitej ideja që gjatë orës së gjuhës shqipe nxënësit të fitojnë aftësi për të lexuar rrjedhshëm dhe të mund t'i shfaqin mendimet e tyre me gojë dhe me shkrim.

Njohuritë dhe shprehjet e fituara në lëndës e gjuhës amtare u krijojnë mundësi nxënësve për njohuri të reja nga fusha të ndryshme.²Ndërkaq, mësimi i gramatikës (morfologji, sintaksë), krahas letërsisë, që ishte e paraparë në plan-programe, ju mundësonte nxënësve t'i mësojnë rregullat gramatikore të të shprehurit qoftë me shkrim apo me gojë.

Pas viteve shtatëdhjetë, sidomos pas Kongresit të Drejtshkrimit, në të gjitha plan-programet theksohej qartë kërkesa e përvetësimit dhe zbatimit në praktikë të normës së gjuhës letrare dhe synohej që nxënësit të njihen shkallë-shkallë me normën e gjuhës letrare dhe në përshtatje me moshën t'i përvetësojnë bazat e saj të domosdoshme teorike dhe të aftësohen për t'i zbatuar ato në praktikë.³

Pothuajse në të gjitha programet e gjuhës të të gjitha moshave brenda dhe jashtë shtetit amë, në mënyrë të qartë theksohet, që nxënësit nëpërmjet mësimi të gjuhës amtare të formojnë: *aftësi komunikimi me gojë dhe me shkrim, njohuri mbi sistemin gjuhësor të shqipes, të mund të formojnë koncepte, të mbartin mesazhe etj.*

Plan-programet e parapara të gjuhës dhe letërsisë për nxënësit e nëntëvjeçares janë hartuar në atë mënyrë që t'u ndihmojnë nxënësve, që në mënyrë aktive:

- *t'i zhvillojnë aftësitë e leximit, shkrimit, komunikimit, si dhe të kultivojnë mendimin e tyre krijues;*

- *në bazë të njohurive të tyre gjuhësore, të dinë t'i vënë në dukje kompetencat e tyre gjuhësore dhe letrare në jetën e përditshme;*

¹ Papahristo, S., *Ushtrimet gjuhësore dhe hartimet në shkollat fillore dhe të mesme*, botim i Ministris s'Arsimit, Shtëpia Botonjëse "Kristo Luarasi", Tiranë, 1938, f. 5.

² *Programi i shkollës tetëvjeçare*, klasat I-IV fillore, Tiranë, 1963, f. 4.

³ *Programi i gjuhës shqipe, i leximit dhe i leximit letrar*, 1984, f. 5.

- të mund në mënyrë të pavarur dhe të drejtë të përdorin gjuhën në jetë; të përvetësojnë njohuri bazë nga letërsia kombëtare e botërore etj.

Të gjitha shkollat shqipe, në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni, në mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës, në programet e tyre të gjuhës shqipe është paraparë përvetësimi i gramatikës së gjuhës shqipe dhe ligjshmërive të saj, drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi, të shprehurit me gojë dhe me shkrim në mënyrë sa më të pavarur dhe origjinale. Kështu, detyrë kryesore e plan-programeve mësimore të gjuhës amtare gjithkund në botë është të nxit interesim tek nxënësit për gjuhën dhe letërsinë dhe t'i mundësojë nxënësit të jetë një lexues aktiv dhe më komunikues, të ketë njohuri mbi kulturën e vet dhe të popujve të tjerë dhe të jetë aktiv në jetën shoqërore.

Përvetësimi i gjuhës amtare në shkollë

Themeluesi i gramatikës gjenerative, Naum Çomski (Noam Chomsky), thekson rëndësinë e aftësive gjuhësore të lindura, të cilat ndihmojnë në përvetësimin e mëtutjeshëm të gjuhës amtare, por edhe të gjuhës së huaj. Kështu, në aspektin psikologjik përvetësimi i gjuhës njihej si koncept i të mësuarit dhe kishte për qëllim që një nxënës t'i përvetësonte shprehitë e duhura gjuhësore. Prandaj, në mësimin e gjuhës amtare, por edhe gjuhëve të tjera sipas parimeve bihevisoriste ofroreshin një sërë ushtrimesh gjuhësore për përvetësimin sa më të lehtë të gjuhës amtare.

Sipas teorisë gjenerative, gjuha dallon nga aftësia e njohjes e cila mbështetet në mekanizmin e lindur për përvetësimin e gjuhës. Çomski dallon *kompetencën* dhe *performansën* në përdorimin e drejtë të gjuhës në situata konkrete. Njohja e një gjuhe është në fakt përvetësimi i gramatikës, sepse fëmijët lindin me aftësi gjuhësore dhe njohuri të përgjithshme të një forme që ka një gjuhë.

Njohuritë universale të gjuhës manifestohet kryesisht në sintaksë, kështu gjenerativistët theksojnë rëndësinë dhe ndarjen e sintaksës nga përbërësit e tjerë gjuhësorë. Mësuesit mund të ndihmojnë në zotërimin e gjuhës standarde shqipe, në njohjen e drejtpërdrejtë dhe të perceptuar të gjuhës. Mësimi i drejtpërdrejtë i gramatikës së gjuhës amtare ndihmon për të shmangur format e gabuara gjuhësore, në ruajtjen e rendit të fjalëve në fjali dhe përdorimin e drejtë të tyre. Me qëllim të zotërimit të gjuhës standarde shqipe, mësimi i gramatikës varet nga kushtet më të ndryshme, për mënyrën se si ju shpjegohen nxënësve rregullat gramatikore, qofshin ato fonetike, morfologjike e sintaksore.

Megjithatë, përgjigja teorike ndaj qëndrimeve të gjenerativistëve ka nxitur një qasje më ndryshe mbi njohuritë gjuhësore. Kështu, Della Hymes (1966, 1970), është krijuar i termi kompetencë përdorimi (*engl. competence for use*), me të cilën i kundërvihet ndarjes së gjenerativistëve në aftësi (kompetencë) dhe të performancë.

Pastaj ky nocion u quajt edhe *aftësi komunikimi*. Ky nocion është aktual dhe si i tillë gjen përdorim më të gjerë, sepse komunikimi është aftësi që i kundërvihet konceptit *aftësisë gjuhësore*, ose me të, bashkohen në konceptin *aftësi e komunikimit gjuhësor* (*engl. communicative language competence*). Ky është koncepti më i njohur i kornizës teorike për studimin dhe mësimin e gjuhës amtare apo të një gjuhe tjetër. Mësimdhënësve më së shumti ju përgjigjet fjala *kompetencë sesa mundësi* (e cila i bashkon fjalët *(aftësi dhe shkathtësi)* dhe nocionet *aftësi, rezultat, arritje* janë të theksuar në plan-programet e të gjitha shkollave.

Përfundimi

Gjuha shqipe është mjet për të shprehur ndjenjat, idetë, besimet, vlerat, dijet dhe siguron mundësi që nxënësit të ndiejnë fuqinë e saj për të shprehur eksperiencat e tyre dhe për të thyer barrierat që ndajnë individët dhe të tjerët. Mësimi i gjuhës shqipe në shkollë i mundëson nxënësit përvetësimin dhe zhvillimin e kompetencave gjuhësore, në mënyrë që të bëhen qytetarë aktiv dhe me aftësi të mjaftueshme për ngritjen intelektuale dhe kulturore përmes gjuhës.

Gjuha shqipe, si asnjë lëndë tjetër të gjithëve ju mundëson zotërimin e kompetencave kyçe gjuhësore, të cilat janë të domosdoshme për përmbushjen e kërkesave personale, shoqërore dhe profesionale. Mësimi i gjuhës në shkollë mundëson zhvillimin e njohurive në të folur dhe të shkruar, me fjalor të pasur, gjithashtu ndikon tek folësit që t'i rregullojnë format e parregullta të dialektit apo të folmes krahinore. Në këtë mënyrë, pasuron më tepër fjalorin, flet lirshëm, aftësohet të flasë rrjedhshëm dhe të jetë i kuptueshëm si në familje dhe nga shokët e shoqet e kudo që janë.

Roli i mësimin shqip është i pashmangshëm edhe në tek të rinjtë, të cilët nën ndikimin e mjeteve të komunikimit masiv, internetit, e kanë pak vështirë t'u përmbahen rregullave të drejtshkrimit shqip. Mësimi i shqipes në shkollë nuk duhet parë si çështje thjeshtë patriotike, por si mësim që ka karakter të theksuar shoqëror, psikologjik, edukativ, gjuhësor edhe më gjerë. Njohja e mirë e gjuhës standarde e përgatit nxënësin për t'iu përgjigjur sfidave të përditshme të komunikimit jo vetëm në administratë, por edhe në institucione tjera relevante. Gjuha standarde, përkundër vështirësive, duhet të përdoret në variantin e saj të shkruar dhe të folur.

Gjuha standarde mësohet në shkollë dhe pastaj në institucionet tjera publike. Fishman (1978 : 38) vë në dukje se “pranimi formal i gjuhës së kodifikuar përvetësohet dhe përforcohet në sistemin arsimor, pastaj në mjetet e komunikimit masiv.

Përvetësimi i standardit bëhet në shkollë, nëpërmjet praktikës pedagogjike, sepse kultura e komunikimit formohet në shkollë dhe përhapet përmes shkollës. Shkolla është vatra më e rëndësishme ku shoqëria ndërhyt drejtpërdrejt e në mënyrë të planifikuar për të ngulitur normën letrare (Lloshi 2011:229). Përmes ushtrimeve me shkrim gjatë orëve të gjuhës amtare, mësuesi duhet t’ua mësoj nxënësve drejtshkrimin dhe t’u krijojë atyre shprehje komunikimi në gjuhën standarde shqipe.

Literatura

CHOMSKY, N. (1957). *Linguistic structur*. Cambridge: MIT.

CHOMSKY, N. (1972). *Language and mind*. New York: Harcourt Brace Jovanovich.

CHOMSKY, N. (1986). *Knowledge of Language: Its Nature, Origin and Us*. New York: Praeger.

BECI, B. 2011. *Një periodizim ndryshe në historinë e standardizimit të shqipes*, në: QSA, *Shqipja në etapën e sotme*, Botimet Albanologjike. Tiranë.

BECI, B. (2007). *Probleme të mësimit të gjuhës amtare në shkollë*, Ligjëratë me mësuesit e shqipes në shtetet skandinave. Landskrona, Suedi.

ISMAJLI, R. (1991). *Gjuhë dhe etni*. Prishtinë: Rilindja

Tekste mësimore të gjuhës shqipe për klasat V-IX të shkollës 9-vjeçare.

TOPOLLAJ, D., *Zbulohet testamenti i Mithat Frashërit: dokumenti është shkruar plot 78 vjet më parë. Historia e jetës së Mithat Frashërit*, Tirana observer. - p. 3, 7 janar 2007.

Vizione kurrikulare në Kurrikuli dhe shkolla: Gjuhë shqipe dhe lexim letrar, nr. 6, 2004.